



Prishtinë: 20.08.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1023_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1835_07_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.08.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 20.08.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.H. nga Podujeva me shifër të konsumatorit: DPR - 90040466, si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1824_07_18 i datës 09.07.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.06.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i datës 06.10.2016 është në përputhshmëri me rregullat në fuqi, pasi që energjia e harxhuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra dhe vetëm 33.33% e saj është regjistruar e kjo si pasojë e djegies së dy fazave, andaj pjesa e mbetur prej 66.66% duhet të përmirësohet për 6 muajt e fundit. Gjithashtu është theksuar se pasaktësia në matjen e njehsorit elektrik nuk është trajtuar si keqpërdorim, por si humbje e energjisë dhe si tillë edhe është faturuar për gjashtë muajt e fundit. Arsyetimi i dhënë nga DMK në ZRRE se në rrjedhën e energjisë elektrike shpenzimi para dhe pas periudhës kontestuese është i njëjtë nuk duhet të merret si meritore dhe se nuk është theksuar se në muajt e njëjtë të viteve të ndryshme konsumatori ka shpenzuar më shumë apo më pak, pasi në disa muaj ka shpenzuar 300 – 400 kWh e në disa periudha mbi 600 kWh. Gjithashtu përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar sipas procesverbalit të kalibrimit, njehsori ka të djegur fazën S dhe T dhe se si pasojë e kësaj ka regjistruar energji më pak për 66.66%, dhe se ky konstatim duhet të merret si provë e mjaftueshme se njehsori nuk ka bërë regjistrimin e shpenzimit të tërësishëm dhe jo analiza e ZRRE-së. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1824_07_18 i datës 09.07.2018. për konsumatorin A.H. me shifër DPR - 90040466.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se korrigjimi i datës 06.10.2016 është në përputhshmëri me rregullat në fuqi, pasi që energjia e harxhuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra dhe vetëm 33.33%, Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes shkresat e lëndës dhe se gjatë analizës së bërë procesverbalit të inspektimit dhe atë të ndërrimit të njehsorit elektrik dhe ka vërejtur se në procesverbalin e inspektimit është vërejtur se njehsori është në rregull, pastaj është theksuar se është i manipuluar pasi nuk bënë matje L2 dhe L3, si dhe kanë evidentuar edhe pajisjet elektrike. Ndërsa në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik kanë theksuar se njehsori duhet të shkoj për verifikim në Qendrën e Kalibrimit. Pra Bordi i ZRRE thekson sipas këtyre procesverbaleve shihet qartë se ka disa paqartësi dhe se KEDS nuk ka dhënë sqarime lidhur me këto konstatime.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se shpenzimi i energjisë elektrike nuk mund të merret si element meritore pasi gjatë krahasimit të shpenzimeve të energjisë elektrike në disa periudha të caktuara ka dallim në shpenzim, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron sepse shpenzimi i energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorëve. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik nr.41546969 për periudha të njëjta kohore dhe me njehsorin e ri elektrik nr.66394110 për periudha të njëjta kohore, dhe konstaton se nuk ka mos përputhje të shpenzimeve të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE thekson se mesatarja mujore e shpenzimeve të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër kontestues nr.41546969 për periudhën 05/2014 deri në periudhën 07/2016 është **505.12 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.66394110 për periudhën 05/2016 - 05/2018 është **478.12 kWh/muaj**, e që sipas kësaj vërehet qartë se shpenzimi i energjisë elektrike nuk ndryshon si para ashtu edhe pas dhe kjo për një periudhë të gjatë kohore. Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit edhe sipas viteve dhe ka vërejtur se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve e cila do të duhej të veçohej: viti 2014 – **477 kWh/muaj**; 2015 – **541 kWh/muaj**; 2016 – **564 kWh/muaj**; 2017 – **403 kWh/muaj**; 2018 – **397 kWh/muaj**. Bazuar në të gjitha analizat e bëra për shpenzimet mujore të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër (kontestues) nr.41546969, si dhe njehsorin elektrik nr.66394110, Bordi i ZRRE-së nuk ka mundur të konstatoj se njehsori elektrik nr.41546969 nuk ka bërë matje të saktë për periudhat të cilat ngarkohet me korrigjim prej 66.66% pasi që kjo nuk reflekton gjendjen reale të shpenzimit të konsumatorit, ngase po që njehsori nuk do të kishte matur edhe për dy faza atëherë ai shpenzim do të duhej të reflektonte në shpenzimin e energjisë pas rregullimit të saj.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se procesverbali i kalibrimit ku theksohet se njehsori ka të djegur fazën S dhe T dhe se si pasojë e kësaj ka regjistruar energji më pak për 66.66%, dhe se duhet të merret si provë meritore, Bordi i ZRRE-së thekson se për çdo lëndë të konsumatorit nuk duhet të merret për bazë vetëm një procesverbal, respektivisht në rastin e konsumatorit vetëm procesverbali i kalibrimit pa u analizuar detalisht çdo shkresë e lëndë dhe pa bërë analiza detale të shpenzimit të energjisë elektrike. Pse nuk duhet të merret parasysh vetëm procesverbali i kalibrimit e dëshmon fakti se mos matja e energjisë elektrike në njehsorin elektrik, e në rastin konkret të dy fazave të atij njehsori, do të duhej që pas rregullimit të njehsorit elektrik (apo ndërrimit të njehsorit elektrik) të reflektohej në rritjen e shpenzimit të energjisë elektrike në periudhat e mëvonshme të konsumatorit, por që kjo nuk ka ndodhur.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk



është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A.H. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.